



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALKET Z. MANÇKA
ADRESA NR.2, ASIM ZENELI, NR.10,
NR.6
TEL: 693645101

MARRËVESHJE SIGURUESE

Nr. repertori: 7305

Nr. koleksioni: 3490

Tirane më 06/10/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 6 fletë



A2023051400350514032



A2023051400350514032

MARREVESHJE SIGURUESE
MBI KUOTAT E PJESEMARRJES NE SHOQERI

Ne Tirane, sot me date 06.10.2023 (dy mijë e njezete e tre), perpara meje noteres Alton Dhaqo Notetare e Dhomes Kombetare te Notereve, Dega Tirane, me adrese Rr "Asim Zemele", u paraqiten personalisht palet:

BARREMARRES / KREDIDHENES:

RAIFFEISEN BANK SH.A., një bankë e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në Rruga e Kavajës, Tiranë, Shqipëri, dhe regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr.17426, datë 10.07.1997, me NUIS.J61911005B, e përfaqësuar nga përfaqësuesit e saj ligjor Znj. Vilma Bace, dtl. 29.04.1976, atesia Ferdi, lindur dhe banuese ne Tirane, identifikuar me pasaporte me nr. BB3906688, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar dhe Znj. Evis Celiku, e dtl. 23.09.1975, identifikuar me leternjoftimin me nr. 033320220 dhe me nr. personal H55923123I, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar (ketu e me poshte do te quhet Banka ose Barremarres/Kredidhenes),

Dhe

BARREDHENES / KREDIMARRRES:

Shoqeria "NOVA SOLAR SYSTEM" Shpk, e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit datë 24/06/2021, me NUIS M11824016H, me seli ne Tirane Tirane TIRANE Rruga Kajo Karafili, Pasuria 2/423+1-6, e perfaqesuar sipas Vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise nr. 5069 rep date 04.10.2023 nga Z. Ilir Shtufi, i biri Xhemalit, dtl. 13.10.1973, lindur ne Tirane dhe banues ne adresen Rr. "Babe Rexha", Nd. 11, H.11, Njesia Administrative nr. 7, Tirane, identifikuar me leternjoftimin nr. 033617734 dhe me nr. personal H31013090C, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar (ketu e me poshte do te quhet (Barredhenes/Kredimarrres)

BARREDHENES:

Shoqeria "NOVA Construction 2012" shpk, e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit datë 04.12.2012, me NUIS L22404012D, me seli ne Tirane Njesia Bashkiake nr 10, Rruga Kajo Karafili, mbrapa ish lidhjes se shkrimtareve, pallati i shoqerise MC Inerte, e perfaqesuar sipas Vendimit te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise nr. 5070 rep date 04.10.2023 nga Z. Ilir Shtufi, i biri Xhemalit, dtl. 13.10.1973, lindur ne Tirane dhe banues ne adresen Rr. "Babe Rexha", Nd. 11, H.11, Njesia Administrative nr. 7, Tirane, identifikuar me leternjoftimin nr. 033617734 dhe me nr. personal H31013090C, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar (këtej e tutje referuar si Barredhenes)

Agim Zeqo, i biri i Nazmi, dtl. 26.08.1968, lindur ne Korce, identifikuar me leternjoftimin ID me nr. 033727389 dhe m enr. Personal G80826036H, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i perfaqesuar sipas prokures se posacme nr. 1220 rep nr. 972 kol date 09.09.2023 nga Z. Enea Mitrush, i dtl. 23.08.1985, lindur ne Fier, identifikuar me Leternjoftimin ID me nr. 034658394 dhe nr personal I50823030K, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar (këtej e tutje referuar si Barredhenes)

Enada Zeqo e bija e Vangjush, dtl. 20.12.1976, lindur ne Korce, identifikuar me Leternjoftim ID nr. 035588639 me nr. personal H66220055W, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar (ne cilesine e bashkeshortes se barredhenesit e cila jep pelqimin per nenshkrimin e kesaj kontrate)

Baza Ligjore

Kjo kontrate hartohet bazuar ne nenet 6, 24, 31, 420, 605, e ne vazhdim te Kodit Civil,

- Ligjit Nr. 110/2018 "Per Noterine"

- Ligjit nr.8537, date 18.10.1999 "Per barret siguruese" (i ndryshuar)

- Ligji nr. 9887, date 10.03.2008 "Per Mbrojtjen e te dhenave personale";

Neni 1

INTERPRETIMI

1.1 PERKUFIZIME

Ne kete Marreveshje, termat dhe shprehjet qe vijojne do te kene kuptimet e meposhtme:

(a) "Kolateral" ka kuptimin qe i eshte dhene ketij termi ne Nenin 2.1 te kesaj marreveshjeje.

(b) "Detyrime" do te thote te gjitha detyrimet, pergjegjesite dhe borxhet e cfaredo natyre apo lloji te Barredhenesit ndaj Barremarresit (duke perfshire ketu interesin, tarifat ligjore dhe shpenzimet) qe ai i detyrohet kohe pas kohe, te tashme apo te ardhme, te sigurta apo te mundshme,



A2023051400350514032

te maturuara apo jo, te zgjeruara apo te rinovuara qofshin, te marra persiper ne cdo kohe dhe nga kushdo, dhe cdo balance perfundimtare te papaguar deri tani.

(c) "Borxhe te tjera" do te thote libra, dokumente, shkresa, letra, shenime dhe te dhena elektronike, si dhe te gjitha llogarite e tashme dhe te ardhme, borxhet, pretendimet, detyrimet ne para dhe kerkesat e cdo natyre dhe lloji pavaresisht nese jane te evidentuara nga instrumentet, te cilat jane kerkuar ose do te kerkoehen, do te paguhen, detyrime keto te Barrdhenesit dhe te gjitha te ardhurat prej tyre.

(d) "Kuota" ka kuptimin e kuotave te pjesemarrjes ne shoqeri dhe te drejttat e lidhura me to sipas legjislacionit ne fuqi

(e) "Detyrime te siguruara" ka kuptimin qe i eshte dhene ketij termi ne Nenin 3.1 si vijon

(f) Te Drejttat e Lidhura "do te thote:

- (i) cdo dividend ose interes i paguar ose i pagueshem ne lidhje me Kuotat;
- (ii) cdo kuote, letra me vlere, te drejta, te holla ose pasuri te lindura ose te ofruara ne cdo kohe (nese me ane te kthimit, bonus, preferimit, te drejtave me kusht, zevendesimin, kembimin ose ndryshe) ne lidhje me ose mbi cilendo nga Kuotat;
- (iii) te gjitha dividente, interesat ose te ardhura te tjera ne lidhje me cdo aset te pemendur ne paragrafin (ii) me lart; dhe
- (iv) te gjitha te drejttat e votes ne lidhje me Kuotat, te cilat mund te ushtohen si ne asamblene e zakonshme, ashtu edhe ne asamblene e jashtezakonshme te Shoqerise.

Neni 2

BARRA SIGURUESE

2.1 KRIJIMI I BARRES SIGURUESE

Barredhenesit ketu shoqeria "NOVA Construction 2012" shpk Z. Agim Zeqo jane ortaket e shoqerise "NOVA SOLAR SYSTEM" Shpk e organizuar sipas ligjeve te Republikës së Shqipërisë, regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit date 24/06/2021, me NUIS M11824016H, me seli ne Tirane Tirane TIRANE Rruga Kajo Karafili, Pasuria 2/423+1-6. Sipas Ekstraktit te Regjistrimit Tregtar per te dhenat e Subjektit Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar struktura e ortakeve te kesaj shoqerise paraqet si ortak te saj barredhenesit si me poshte vijon:

- shoqeria "NOVA Construction 2012" shpk - 80% te kuotave
- Z. Agim Zeqo - 20% te kuotave

Me ane te kesaj marreveshje siguruese Barredhenesit ketu i japin Barremarresit nje Barre Siguruese mbi kuotat ne total 100% te kuotave qe shoqeria "NOVA Construction 2012" shpk Z. Agim Zeqo zoterojne tek shoqeria "NOVA SOLAR SYSTEM" Shpk me te cilat sigurojne pagesen, permbushjen dhe shlyerjen e te gjitha detyrimeve te siguruara te Shoqerise "NOVA SOLAR SYSTEM" Shpk, ndaj Barremarresit.

Neni 3

DETYRIMET E SIGURUARA

3.1 DETYRIMET E SIGURUARA

Barra Siguruese qe jepet siguron pagimin dhe permbushjen e te gjitha detyrimet monetare (dhe detyrimet te cilat mund te vlersohen ne te holla) dhe detyrimet e Kredimarrjesit kundrejt Kredidhenesit sve sipas Kontratave te Kredise me poshte, duke perfshire, por pa rene ne kundershtim me parashikimet e pergjithshme parardhese, permbushjen e duhur te te gjitha detyrimeve per pagesat ne lidhje me kryegjene, interesat, kamat-vonesat, tarifat, kostot dhe shpenzimet, demet, taksa dhe taksat e pulles te pagueshme, cdo shume per sherbime ndermjetesimi qe do te paguhen pas parapagimit ose ripagimit te te gjitha apo nje pjese te Kredise ne nje date tjetër nga data e caktuar per pagesen, dhe te gjitha e çdonjera prej kostove, shpenzimeve, takse pulle, taksat apo tarifat e pagueshme ne lidhje me mbrojtjen, ruajtjen apo ekzekutimin e detyrueshem te te drejtave te Kredidheneve sipas Kontrate Kredie Bankare nr. 7303 rep, nr. 3488 kol, date 06/11/2023 (referuar ne kete marreveshje si Kontrate Kredie) dhe te gjitha detyrimet e Shoqerise dhe te Barredhenesit sipas kesaj Marreveshjeje te lidhur ndermjet Kredidhenesit dhe Kredimarrjesit.

3.2 INTERESI I VAZHDUESHEM

Kjo Kontrate do te jetë gjithashtu e detyrueshme për barredhenesit edhe pas ndonjë ndryshimi, transferimi ose rinovimi të Kontratës së Kredisë ose të kësaj Kontrate. Barredhenesi në mënyrë të shprehur bie dakort për vazhdimësinë e kësaj Kontrate në rast të rinovimit të të gjithë ose të një pjese të Detyrimeve të Siguruara (duke përfshirë një rinovim të Kontratës së Kredisë)

3.3 APLIKIMI I PAGESAVE

Te gjitha parate e mbledhura apo te marra nga Barremarresi prej Barredhenesit do te shkojne per llogari te permbushjes se Detyrimeve ne menyren qe vete Barremarresi ka vendosur.

Neni 4

MARREVESHJET E BARREDHENESIT

4.1 MARREVESHJE TE PERGJITHSHME

Barredhenesi bie dakord qe:

(a) do te njoftoje Barremarresin menjehere per:

- cdo ndryshim te emrit te Barredhenesit;

- cdo ndryshim te vendit ku Barredhenesi zhvillon aktivitetin e tij tregtar ose, nese Barredhenesi ka me shume se nje vend te tille, te selise kryesore te Barredhenesit;

- cdo rast mospermbushjeje (sic eshte perkufizuar me poshte ne nenin 6);

(b) do te autorizoj barremarresin te beje, ekzekutoje, njohe dhe shperndaje formularet e njoftimit te regjistrimit dhe kalime te metejshme te dhe transfertave, dokumenteve, akteve, ceshtjeve dhe gjerave, duke perfshire shtojcat e metejshme te kesaj Marreveshjeje ne menyre qe kjo Marreveshjeje te kete efekt.

(c) Barredhenesi bie dakort dhe pranon qe ne rast mospermbushjeje barremarresi ka te drejte te kryerje ekzekutimine detyrueshem te barreve siguresse ne perputhje me Ligji "Per barret siguruese" dhe Barredhenesi nuk do te kerkoje procedure te ndryshme ekzekutimi nga ajo e parashikuar ne ligj duke hequr dore nga e drejta per ushtrim te Nenit 32 te ketij ligji.

4.2 SHPENZIMET

Barredhenesi duhet t'i paguaje Barremarresit, sipas kerkeses se gjitha kostot e arsyeshme te Barremarresit, taksat dhe shpenzimet duke perfshire, pa perjashtim, pagesat ligjore ne lidhje me pregatitjen, regjistrimin ose ndryshimin e kesaj Marreveshjeje, kompletimin apo ruajtjen e Barres Siguruese, zbatimin ne cdo forme te dispozitave ose ushtrimin e te drejtave, fuqive dhe mjeteve ligjore sipas Marreveshjes apo sipas Ligjit "Per barret siguruese".

Neni 5

ARKETIMI I BORXHEVE

Perpara ose pas Mospermbushjes, Barremarresi mund t'i jape njoftim mbi Barren Siguruese cdo personi qe eshte i detyruar te paguaje nje borxh apo detyrim qe perben Kolateral dhe mundet gjithashtu t'i drejtohet cdo personi per te bere te gjitha pagesat per llogari te nje borxhi te tille ndaj Barremarresit. Barredhenesi pranon qe cdo pagese e marre prej tij nga persona te tille ne rast Mospermbushjeje, qe eshte ne vazhdim, perpara apo pas njoftimit te ketij personi mbi Barren Siguruese, do te merret dhe mbahet nga ai per Barremarresin dhe do t'i jepet Barremarresit sipas kerkeses se tij. Ne rast Mospermbushje, Barredhenesi bie dakord te depozitoje te gjitha te ardhurat qe rezultojne ne llogarine e tij ne favor te Barremarresit ne banken e aprovuar nga Barremarresi.

Neni 6

RASTET E MOSPERMBUSHJES

Rastet kur njera nga ngjarjet e meposhtme ndodh apo kushtet qe vijojne perbejne mospermbushje, qe ketej e tutje do t'u referohemi si "Rast i Mospermbushjes":

(a) deshtimi per te permbushur cdo lloj detyrimi, duke perfshire pa asnje kufizim mospagimin e principalit, interesave apo shuma te tjera qe perbejne pjese te Detyrimit te papaguar ne kohen e duhur sipas parashikimeve te Detyrimeve te Siguruara;

(b) keqinterpretimi thelbesor nga ana e Barredhenesit ne cdo marreveshje ose transakcion ndermjet Barredhenesit dhe Barremarresit;

(c) falimentimi ose mungesa e aftesise paguese te Barredhenesit, njoftimi kunder Barredhenesit i procedurave te falimentimit;

(d) cdo proces gjyqesor qe behet i ekzekutueshem kunder Barredhenesit apo Kolateralit;

(e) nese nje pale tjetere qe ka pretendim mbi barren siguruese kunder pasurise se Barredhenesit ben hapa per te ekzekutuar barre siguruese te saj;

(f) nese Barredhenesi pushon apo paralajmeron se do te pushoje veprimtarine e vet tregtare, shet ose bie dakord te shese nje pjese te konsiderueshme te aseteteve te veta pa zbatuar ligjin perkates ose pa e njoftuar Barremarresin;

(g) nese, sipas Barremarresit, ne kushte te arsyeshme tregtare, Barra Siguruese ose Kolaterali vihet ne rrezik.



A2023051400350514032

6.2 PERSHPEJTIMI

Ne rast Mospermbushjeje dhe ne cdo kohe me pas, Barremarresi nga ana e tij mund te deklaroje nje pjese ose te gjitha Detyrimet qe nuk konsiderohen te pagueshme me ane te kerkeses, te behen menjehere te tilla pa bere ndonje kerkese apo njoftim.

6.3 MJETET LIGJORE NE RAST MOSPERMBUSHJEJE

Ne rast Mospermbushjeje, plus te drejtave dhe mjeteve ligjore te tjera qe mund te kete sipas ligjit, Barremarresi mund:

- Te zgjedhe te mbaje te gjithe apo nje pjese te kolateralit ne permbushje te detyrimeve te Barredhensit sipas kesaj marreveshje ne menyren e parashikuar ne ligjin "Per Barret siguruese"
- Te marre, te arketoje, te shese, te jape me qira, te marre para hua per te siguruara dorezimin e kolateralit tek palet e treta ose te veproje me kolateralin apo nje pjese te tij ne menyre te tille, sipas kushteve dhe termave te tilla, dhe ne kohën qe lejohet nga ligji "Per barret siguruese"; si dhe mund te kerkoje ne emer te tij dhe t'u paguaje te tjereve shuma te arsyeshme per shpenzimet e marra persiper dhe per sherbimet e kryera ne lidhje me marrjen, arketimin, kryerjen, marrjen e huase per sigurimin, shitjen e kolateralit ose fitimin e pagesave nga ai dhe mund t'ia shtoje sasine e ketyre shumave borxhit qe Barredhensit ka ndaj Barremarresit.
- Te vazhdoje te ekzekutoje pagesat dhe te ushtroje te drejtat dhe mjetet ligjore te Barremarresit per te cilat parashikohet ne ligjin "Per barret siguruese" si dhe te gjitha te drejtat dhe mjetet ligjore ne dispozicion te barremarresit te cilat nuk bien ne kundërshtim me legjislacionin shqiptar

6.4 MJETET LIGJORE JO-PERJASHTUESE

Te gjitha te drejtat, fuqite dhe mjetet ligjore te Barremarresit sipas kesaj marreveshjeje mund te ushtrohen ne vecanti ose te kombinuara dhe nuk zevendesojne, por jane shtese e cdo forme sigurimi ne vazhdim nga Barremarresi dhe te gjitha te drejtat e tjera, fuqite apo mjetet ligjore te Barremarresit, pavaresisht nga forma se si kane lindur apo jane krijuar.

6.5 PERGJEGJESIA PER MUNGESAT

Per sa kohe eshte ne perputhje me ligjin e zbatueshem, Barredhensit mbetet pergjegjes per permbushjen e cdo Detyrimi qe nuk eshte permbushur plotesisht ose shlyer nga dhenia e te ardhurave qe lindin nga zbatimi i Barre Siguruese kundrejt Detyrimeve te Siguruara.

6.6. MBARIMI I BARRËS SIGURUESE

- Barra Siguruese e vendosur Kolateral sipas Nenit 2, ne cdo rast, mbetet ne fuqi deri ne permbushjen ne menyre te plote të gjithave detyrimeve që rrjedhin nga Kontrate Kredie Bankare nr. 7303 rep, nr. 3488 kol, date 06/01/2023. Ajo rregjistrohet me nje afat fillestar prej 10 vjet duke filluar nga data e regjistrimit te kesaj Marreveshje Siguruese prane Regjistrimit te Barreve Siguruese me te drejte rinovimi te ketij rregjistrimi nga ana e Bankes, deri ne permbushje te plote te detyrimeve te Kontrates se Kredise per te cilat eshte vendosur barra siguruese.
- Barra Siguruese do t'i lirohet Barrëdhënsit vetëm pas përmbushjes në mënyrë të plotë dhe të përvokueshme të të gjithave detyrimeve që rrjedhin nga Kontrate Kredie Bankare nr. 7303 rep, nr. 3488 kol, date 06/01/2023 duke kryer njëkohësisht edhe ç' regjistrimin nga Regjistri i Barreve Siguruese.

Neni 7

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

7.1 VAZHDIMESIA E SIGURISE

Kjo Marreveshje dhe Barra Siguruese e krijuar sipas saj nuk zevendesojne por konsiderohen si shtese e barreve te tjera siguruese te mbajtura nga Barremarresi, dhe konsiderohet nje Marreveshje ne vazhdimësi dhe Barre Siguruese deri kur perfundon me shkrim dhe nenshkruhet nga palet.

7.2 KOMUNIKIMI



A2023051400350514032

Kur cdonjeres nga palet i kerkohet apo i jepet e drejta te njoftoje, te drejtoje ose t'i beje nje kerkese pales tjetere, ky njoftim, drejtim apo kerkese duhet te jete me shkrim dhe quhet i mjaftueshem kur dergohet me poste te thjeshte tek kjo pale, ne adresat e fundit te raportuara nga pala.

7.3 PASARDHESIT DHE CESIONARET

Kjo Marreveshje duhet te jete e detyrueshme per Barredhenesin dhe pasardhesit e tij ose saj dhe duhet te siguroje qe eshte ne favor Barremarresit, pasardhesve te tij dhe cesionareve. Kjo Marreveshje duhet te jete e cedueshme (transferueshme) nga Barremarresi qe eshte i lire nga pretendimet ndermjet Barredhenesit dhe Barremarresit, dhe Barredhenesi nuk ka te drejte t'i kundervihet cesionarit apo te ngreje ndaj tij pretendimet qe ai ka ndaj Barremarresit.

7.4 PRANIMI I SHOQERISE

Shoqeria pranon detyrimet e premtimet e Barredhenesit sipas kesaj Marreveshjeje dhe bie dakort te mos ndermarre asnje veprim qe mund te cenoje ose ndaloje zbatimin e tyre.

Neni 8

VERIFIKIMI DHE RAPORTIMI I TE DHENAVE

Palet ne kete kontrate deklarojne dhe garantojne me vullnetin e tyre te plotë dhe të lirë se informacioni i dhënë prej tyre, është i vërtetë, i saktë dhe i plotë dhe bien dakord dhe deklarojne si me poshte:

Duke kuptuar se, të dhënat e mia demografike dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë, do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar, si dhe sekretin profesional, si dhe për faktin se Raiffeisen Bank sha dhe Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë kanë marrë të gjithat masat e nevojshme për të garantuar trajtimin e sigurt të të dhënave të mia:

I jap pëlqimin tim të plotë, të lirë Raiffeisen Bank sha që, për qëllimet që përfshijnë:

1. Vlerësimin e aplikimit për të marrë kredi;
2. Vlerësimin e rrezikut të kredisë përgjatë të gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies time të kredisë me Raiffeisen Bank sha ;
3. Vlerësimin e besueshmërisë time si person i lidhur me kredimarrësit,

të njihet me detyrimet e mia ndaj institucioneve financiare kredidhënëse, nëpërmjet përpunimit të autorizuar të të dhënave të Regjistrin të Kredive, për të vlerësuar vlerën e ekspozimit kreditor në sistemin bankar e financiar, garancitë dhe besueshmërinë/ aftësinë për të shlyer detyrimet financiare. Gjithashtu, jap pëlqimin tim që Raiffeisen Bank sha të përdorë emrin dhe të dhënat e mia identifikuese dhe financiare, për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë.

Jemi informuar siç duhet për të drejtën tone për të kërkuar informacion mbi të dhënat tona gjatë periudhës së mbajtjes së tyre nga Raiffeisen Bank Sha, si dhe korrigjimin/ rishikimin, në raste kur ato janë të pasakta, të paplota. Për një qëllim të tillë, unë jam i vetëdijshëm që çdo kërkesë për sa më sipër mund t'ia drejtoj Raiffeisen Bank si më poshtë:

- Në vëmendjen e Personit Përgjegjës i Raiffeisen Bank sha të cilit mund ti adresohen pretendimet mbi të dhënat e raportuara
- Adresa: Raiffeisen Bank, Rr. Tish Daija, Kompleksi KIKA 2, Tirane
- E-mail: rbaal.dataprotection@raiffeisen.al
- Telefoni: +355698022250
- Faqja e internetit: <https://www.raiffeisen.al/>

Kemi lexuar dhe kuptuar me kujdes përmbajtjen e kësaj klauzole të pëlqimit paraprak dhe njohim pasojat përkatëse ligjore në lidhje me përpunimin e të dhënave tona personale, informacionit financiar dhe/ose çdo informacioni tjetër në lidhje me veten time në cilësinë e Kredimarrësit/ Dorezanesit dhe për këtë arsye unë e nënshkruaj këtë dokument me vullnetin tim të plotë dhe të lirë

Ky autorizim konsiderohet i dhene per te gjithë personat nenshkrues te kontrates, pra si per Kredimarrësit dhe te dhenat e tyre, ashtu dhe per Dorezanesit dhe /apo Garantoret.

9. TE NDRYSHME



A2023051400350514032

- 9.1 Kjo marreveshje do te zbatohet dhe do te interpretohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
- 9.2 Barredhenesi autorizon Barremarresin te rregjistroje formularet e njoftimit te rregjistrimit dhe dokumenta te tjere dhe te ndermarre te gjitha veprimet qe Barremarresi mund te mendoje se jane te nevojshme per te kompletuar dhe vazhduar kompletimin e Barres Siguruese, per te mbrojtur dhe ruajtur Kolateralin dhe per te ekzekutuar barren siguruese;
- 9.3 Kjo marreveshje eshte pjese e Kontrates se Kredise ne Llogarine Rrjedhese dhe e detyrueshme si per palet nenshkruese, ashtu dhe per personat qe mund te zene vendin e tyre ose te cileve u jane transferuar te drejtat apo detyrimet.
- 9.4 Palet mund te ndryshojne vetem me shkrim elementet e kesaj marreveshjeje dhe t'i pasqyrojne ato ne Regjistrin e Barreve Siguruese.
- 9.5 Mosmarreveshjet e paleve zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert kompetente do te jete Gjykata e Shkalles se Pare Tirane.
- 9.6 Marreveshja nenshkruhet ne 6 (gjashte) kopje origjinale nese eshte rasti ne prani te perkthyesit, nga te cilat nje kopje per Barredhenesin/Kredimarresin, dy per Kredidhenesin/Barremarresin dhe nje kopje depozitohet prane noterit.

BARREMARRES/ KREDIDHENESI
RAIFFEISEN BANK sha

Perfaqesuar nga:
Vilma BACE



Evis CELIKU



BARREDHENES/KREDIMARRES
Shoqeria "NOVA SOLAR SYSTEM" Shpk

Perfaqesuar nga
Ilir SHTUFI





BARREDHENES:
Shoqeria "NOVA Construction 2012" shpk


Perfaqesuar nga
Ilir SHTUFI





Agim ZEZO ZEZO perfaqesuar me prokure nga
Enea MITRUSHI



Enada ZEZO






NOTER




EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	M11824016H	
2. Data e Regjistrimit	24/06/2021	
3. Emri i Subjektit	NOVA SOLAR SYSTEM	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	04/06/2021	
6. Kohëzgjatja	Nga: 04/06/2021	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga Kajo Karafili, Pasuria 2/423+1-6	
8. Kapitali	45.000.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00	
9. Objekti i aktivitetit	<p>Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese të energjisë elektrike fotovoltaike dhe gjithë llojeve të tjera të prodhimit të energjisë dhe veprave ndihmese në Bashkinë Bilisht, Bashkinë Sarandë, Bashkinë Fier dhe në gjithë territorin e Shqipërisë. Prodhim Energjie Fotovoltaike, Hidrike, Solare, etj. Shit-Blerje Energjie Fotovoltaike, Solare, Hidrike, etj. Import Eksport të të gjitha llojeve të materialeve dhe transport. Aplikimi dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Institucionet e Shtetit Shqiptar i të gjitha lejeve dhe licencave të cilat mundesojnë zhvillimin e këtij aktiviteti në mënyrë të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo lloj aktiviteti të parasikuar nga ligji në përputhje me rregullat e dispozitat në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në baze të autorizimeve dhe/ose lejeve perkatese të leshuara nga organet kompetente të fushës.</p>	
10. Administratori/ët	Ilir Shtufi	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 04/06/2021	Deri: 04/06/2026
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Administratori/ët	Edmond Zalla	
12.1 Afati i emërimit		

	Nga: 26/09/2022	Deri: 26/09/2027
13. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore 13.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)	<p>Ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te shoqerise, se bashku apo vec e vec nga administratori ekzistues Ilir Shtufi, duke zbatuar politikat tregtare, statutin dhe ligjin Shqiptar ne fuqi, ta perfaqesoje ate ne te gjitha marredheniet qe ajo ngre perfshre nenshkrimin e akteve te ndryshme etj, duke perjashtuar (kufizuar) te drejten e tij per nenshkruar kontrata kredie, kontrata huaje/huaperdorje apo cdo lloj veprimi banker.Ka te drejten e perfaqesimit e shoqerise prane cdo instuticioni shteteror si Drejtori Tatimore, Zyrat e Punes, Prokurori, Polici, Bashki, QKB etj, duke patur te drejte te nenshkruaje, depozitoje, terheqe, kerkoje cdo informacion apo dokument lidhur me Shoqerine.Perfaqesimin e Shoqerise prane cdo instuticioni shteteror si Drejtori Tatimore, Zyrat e Punes, Prokurori, Polici, Bashki, QKB etj, duke patur te drejte te nenshkruaje, depozitoje, terheqe, kerkoje cdo informacion apo dokument lidhur me Shoqerine "Nova Solar System".Te gjitha veprimet e kryera nga Administratori Z. Edmond Zalla brenda afatit te tij sipas kufizimeve te percaktuara, jane te autorizuar dhe te njohura nga ortaku, duke gezuar te drejten per te vepruar se bashku dhe/ose me vete nga administratori ekzistues Kujtim Shtufi</p>	
14. Ortakët	AgimZeço	
14.1 Vlera e kapitalit	Para: 9.000.000,00	Natyre:
14.2 Numri i pjesëve	1,00	
14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	20,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
15. Ortakët	NOVA Construction 2012	
15.1 Vlera e kapitalit	Para: 36.000.000,00	Natyre:
15.2 Numri i pjesëve	1,00	
15.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	80,00	
15.4 Komente (nëse ka)		
16. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Fier Fier FIER "Rruga Sheq Marinas, Fier, Pasuria Nr.114/1, Vol.11, Fq.51, ZK.3358"	
17. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: NOVA SOLAR SYSTEM E-Mail: info@novasolar.com.al finance@novasolar.com.al	



	Telefon: 0685902017 0692462022
18. Statusi:	Aktiv

Datë: 06/10/2023

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

OKB

VENDIM

Nr. 12 date 03/10/2023

ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE AKSIONEREVE/ORTAKEVE TE SHOQERISE

“Nova Solar System” shpk

Sot, me date 03/10/2023 në selinë e Shoqërisë “Nova Solar System” shpk, e regjistruar në organet tatimore dhe QKB me numër me Nipt Nr.M11824016H me ortake Shoqerine “Nova Construction 2012” shpk e regjistruar në organet tatimore dhe QKB me numër NIPT L22404012D, dhe Z.Agim Zeqo, në mbështetje të Statutit dhe Aktit të Themelimit të Shoqërisë, bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme ku te pranishem ishin:

- Shoqëria “Nova Construction 2012” shpk është ortakë zotëruese e 80 % të kapitalit të Shoqërisë “Nova Solar System” shpk.
- Agim Zeqo, është ortakë zotëruese e 20 % të kapitalit të Shoqërisë “Nova Solar System” shpk.

Njoftimi për mbledhjen e asamblesë dhe rendin e ditës është dërguar tek aksionerët/ortakët dhe sot në mbledhje janë të pranishëm aksionerët si më sipër përcaktuar.

Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve/Ortakëve u mbledh për të diskutuar dhe vendosur sipas rendit të ditës si më poshtë vijon:

1. Miratimin për marrjen e një linje kredie bankare pranë Raiffeisen Bank në vlerën EUR 14.000.000 me qëllim për ndërtimin e Parkut fotovoltaik 50 MW dhe për mbylljen e detyrimeve të shoqërisë “NOVA Construction 2012” shpk që rrjedhin nga Kontrata Kredie nr. 4720 rep nr. 2437 kol date 29.06.2023 deri në shumën prej 2.200.000 Eur (e përdorur për blerjen e paneleve fotovoltaike për projektin).
2. Miratimin për vendosjen si garanci të paketës së kolateralit si më poshtë në favor të Bankës me qëllim garantimin e kredisë së miratuar në pikën 1:
 - Vendosjen kolateral të pasurive me nr. 114/1, 12/8, 13/5, 11/6, 14, 12/3, në favor dhe në tradhe të pare dhe të vetme të Raiffeisen Bank
 - Barre siguruese mbi llogaritë bankare të shoqërisë pranë RBAL
 - Barre siguruese mbi të ardhurat nga të gjitha kontratat e tashme dhe të ardhme që do të nënshkruajë për shtimin e energjisë.
 - Kolateral financiar mbi llogarinë rezerve (DSRA), në shumën jo më pak se 850.000 Eur të kompanisë pranë Raiffeisen Bank.
 - Garanci personale e aksionerëve të shoqërisë
 - Barre siguruese mbi kuotat e tashme dhe të ardhshme të shoqërisë

Autorizimin e Z. Ilir Shtufi, që në emër të shoqërisë të negociojë, dhe të firmosë të gjitha kontratat respektive dhe të gjitha dokumentet e nevojshme të lidhura me këtë financim pranë Raiffeisen Bank sh.a

Asambleja e Aksionerëve/Ortakëve mori në shqyrtim çështjet e ngritura dhe pasi diskutoi vendosi me unanimitet sa më poshtë:

1. Miratimin per marrjme e nje linje kredie bankare prane Raiffeisen Bank ne vleren EUR 14,000,000 me qellim per ndertimin e Parkut fotovoltaiik 50 MW dhe per mbylljen e detyrimeve te shoqerise "NOVA Construction 2012" shpk qe rrjedhin nga Kontrate Kredie nr. 4720 rep nr. 2437 kol date 29.06.2023 deri ne shumen prej 2,200,000 Eur (e perdorur per blerjen e paneleve fotovoltaiike per projektin).
2. Miratimin per vendosjes si garanci te paketes se kolateralit si me poshte ne favor te Bankes me qellim garantimin e kredise se miratuar ne piken 1:
 - Vendosjen kolateral te pasurive me nr. 114/1, 12/8, 13/5, 11/6, 14, 12/3 , ne favor dhe ne rradhe te pare dhe te vetme te Raiffeisen Bank
 - Barre siguruese mbi llogarite bankare te shoqerise prane RBAL
 - Barre siguruese mbi te ardhurat nga te gjitha kontratat e tashme dhe te ardhme qe do te nenshkruaje per shtijen e energjise.
 - Kolateral financiar mbi llogarine rezerve (DSRA), ne shumen jo me pak se 850,000 Eur te kompanise prane Raiffeisen Bank.
 - Garanci personale e aksionereve te shoqerise
 - Barre siguruese mbi kuotat e tashme dhe te ardheshme te shoqerise

Ky vendim nenshkruhet rregullisht nga ortaket ne dy kopje origjinale, nje prej te cilave do te regjistrohet nepermjet portalit e-albania.

E firmosur sot me date 03/10/2023


ORTAKET PJESEMARRES NE ASAMBLE

Agim ZEQQ

Agim Zeqq

"Nova Construction 2012" shpk

[Signature]



[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER GJERGJ R. KONGOLI



DATE 04/10/2023
NR REP 5069

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 04.10.2023 , para meje Noter GJERGJ R. KONGOLI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA ADMINSITRATIVE NR. 10, RR. MIHAL DURI , u paraqit personalisht:

DEKLARUESIT:


Agim Zeqo, atësia Nazmi, amësia Shpresa, shtetas Shqiptar, lindur në Korçë dhe banues në TIRANË, me adresë Seit Teqja 03950073; Nd. 92; H. 1; Petrelë; Mullet; 1034; Tiranë, lindur më 26/08/1968, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033727389 dhe nr. personal G80826036H , .

Ilir Shtufi, atësia Xhemal, amësia Zonjë, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në TIRANË, me adresë Babë Rexha; Nd. 11; H. 1; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 13/10/1973, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033617734 dhe nr. personal H31013090C , .

Te lartpermendurit, ne cilesine e ortakeve te Shoqerise Nova Solar System shpk, kane redaktuar Vendimi date 03.10.2023 te cilen e nenshkruan ne pranine time.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



NOTER

GJERGJ R. KONGOLI

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L22404012D
2. Data e Regjistrimit	04/12/2012
3. Emri i Subjektit	NOVA Construction 2012
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	03/12/2012
6. Kohëzgjatja	Nga: 03/12/2012
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr.10, Rruga Kajo Karafili, mbrapa ish lidhjes se shkrintareve, pallati i shoqerise MC Inerte
8. Kapitali	100,000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	100,00
9. Objekti i aktivitetit	Ne fushen e projektimit dhe te ndertimit: kat. 1/e-planvendosje e objekteve te vecanta, kat. 2/a, projektme dhe ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etj. Deri ne dy kate dhe kompletimin me instalimet e nevojshme per to, b- projektme dhe ndertime civile industriale, turistike, bujqesore etj. Dhe kompletimin e instalimeve te nevojshme per to; d- Projektim peizazhi (sistemime, lulishte, vepra arti, dekori etj.) e- projektim interieri, mobile, pajisjes, dizajn industrial. Ne fushen e ndertimit per zbatim: punime dhu, sistemime, tarracime, prodhim elementesh te parafabrikuara betoni e betonarmeje dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etj. Dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to, punime elektrike, linja TL, TU, impiante elektrike, telefoni, citofoni, dhe mirembajtja e tyre, ndertim rruge, kat. V, VI ndertime rruge kat. III, II, I, ndertim fusha aviacioni, veshje asfaltobeton te rrugeve (ndertim mbishtrese) si dhe sistemim e asfaltim sheshe, ndertim vepra arti rrugore dhe hekurudhore, ndertime ujesjellesa dhe kanalizime, sillosa, kulla, kulla uji. Pre betonarmeje dhe metalike, punime karpentjerie metalike, shpime pusesh gjeologjike inxhinjrike dhe hidrogjeologjike, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, nivelime topografike, punime topogjeodezike, rikonstruksione godinash civile dhe

	<p>ekonomike, veshje fasadash. Nivelime topografike, punime topogjeodezike, punime sipërfaqe të gjelberia parqe, lulishte, instalimi i impianteve ngritese dhe transportuese (ashensore etj.) instalimi i impianteve të ngrohjes dhe ftohjes, instalimi i impianteve higjenike, instalimi i impianteve nenpresion, restaurimi i ndërtesave monument kulture, punime restaurimi i ndërtesave monument kulture, punime restaurimi në vepra arkeologjike, ndertime gazsjellese, naftesjellese, ndertime diga, galeri, tunele, punime mbrojtje të sistemit hidraulik-9imentime, kanale dhe impiante vaditje, punime karpentiere druri dhe metali, instalimet dhe impianteve nenpresion, instalimet për nenstacionet, kabinat e transformatoreve. Prodhim, import — export beton, beton armeje dhe çdo nenproduktit të tij, intere etj. Organizimi i transportit të udhëtareve dhe të mallrave me mjete të komunikacionit ajror, tokesor dhe detar, çelja e zyrave të agjencive turistike dhe të shitjes së biletave për udhëtime brenda dhe jashtë vendit me të gjitha llojet e mjeteve, organizimin e shërbimeve, ndihme juridike, kurse profesionale për gjuhë të huaja, kompjuter dhe sekretari, shitje kancelari. Në fushën e tregtisë import — eksporti, me shumicë dhe pakicë, të mallrave industriale, ushqimore, bujqësor dhe blegtorale, veshmbathje, konfeksione, prodhime e tregtim të materialeve të ndërtimit, inerte, rere, zhavorr, automjeteve, makinerive, pajisjeve hidrosanitare, mobileve, artikujve kozmetike, lendeve të përpunuara dhe të papërpunuara, e bimeve medicinale, të lendeve drusore, plastike, duraluminit, tregtim me pakicë të karburanteve dhe vajrave lubrifikante. Në fusha të tjera: hapjen e bar bufeve, restoranteve, pikave të servilit, parkim automjeteve, lavazhit, hoteleve, fshatrave turistike, moteleve si dhe agjencive për shitblerje, dhenie me qira të pasurive të mndshme dhe të patundshme, agjencive për shitblerje, agjenci komisioneve, agjenci transporti, transport të udhëtareve dhe të mallrave si brenda vendit ashtu dhe jashtë tij. Vlerësim i ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor, grumbullim, transportim, ruajtje, magazinim, transferim të mbetjeve jo të rezikshme urbane, ujërave të zeza, llumrave, mbetjet nga prishjet dhe ndërtimet</p>	
10. Administratori/ët 10.1 Afati i emërimit	Enea Kaçi Nga: 13/03/2023 Deri: 13/03/2028	
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Administratori/ët 12.1 Afati i emërimit	Basri Troci Nga: 11/07/2016 Deri: 30/06/2026	

<p>13. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore 13.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)</p>	<p>1-Jepet miratimi për Administratoret Basri Troci dhe/ose Enea Kaci që të kryejnë bashkërisht apo dhe vec e vec, në Bankat e nivelit të dytë, të gjitha veprimet dhe transaksionet bankare, të depozitohen, të kryejnë transfera parash për pagesa të ndryshme, të terheqin para, të depozitohen, të rinovojnë afatet e depozitave, si dhe të marrin ekstrakte bankare (bank statements) të Shoqërisë "Nova Construction 2012" shpk. 2-Jepet miratimi që të gjitha veprimet e përmendura më sipër që do të kryen nga Administratoret Basri Troci dhe/ose Enea Kaci, të kryhen brenda afatit të tyre si administrator. Këto veprime të administratorëve bashkërisht apo dhe vec e vec janë të autorizuar dhe të njohura nga ortakët si të drejta.</p>	
<p>14. Eksperti/ët Kontabël (nëse ka) 14.1 Afati i emërimit</p>	<p>SOKOL TOSKA Nga: 19/01/2023 Deri: 19/01/2024</p>	
<p>15. Eksperti/ët Kontabël (nëse ka) 15.1 Afati i emërimit</p>	<p>Mihal Kolani Nga: 31/12/2022 Deri: 19/01/2024</p>	
<p>16. Ortakët 16.1 Vlera e kapitalit 16.2 Numri i pjesëve 16.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) <i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuota si përfaqësues)</i></p>	<p>Ilir Shtufi Para: 91.000,00 Natyre: 91,00 91,00</p>	
<p>17. Ortakët 17.1 Vlera e kapitalit 17.2 Numri i pjesëve 17.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) <i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuota si përfaqësues)</i></p>	<p>Kujtim Shtufi Para: 9.000,00 Natyre: 9,00 9,00</p>	
<p>18. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit</p>	<p>Tirane Tirane TIRANE Rruga Brigada e VIII, Bashkia Tirane, objekti "Godine Polifunksionale" "City Hotel" Tirane Tirane TIRANE Ndertimi i Uzines se Jashtme Tirane, Loti 4 Tirane Tirane TIRANE Rruga "Mine Peza", në Objektivin "Godine Polifunksionale", Tirane, sipas Leje Ndertimi Nr.952/8 Prot, date 23.07.2020 Tirane Tirane TIRANE Rruga 5 Maji, (Objekti Godina 15A) Tirane Tirane TIRANE Ndertimi i rrugeve pedonale dhe rrugeve të brendshme të zonës për zhvillim njesia administrative 4 dhe</p>	

	<p>8, zona "5 Maji"(Faza 1) Tirane Tirane TIRANE Rruga Kajo Karafili, mbrapa ish lidhjes se shkrintareve, pallati i shoqerise MC Inerte Tirane Tirane TIRANE "Godine Banimi, Hoteleri dhe Sherbime 16 kate dhe 17 kate mbitoke me 5 kate nentoke", me vendndodhje ne rrugen "Medar Shtylla". Bashkia Tirane, pajisur me Lejen e Ndertimit me Nr.890/10, date 27.08.2021, miratuar me Vendim Nr.40, date 17.03.2021 te KKT. Tirane Kamez KAMEZ Rindertimi i Shkolles 9 vjecare "Halit Coka" (ish shkolla Elez Isufi) ne kuader te procesit te rindertimit, Bashkia Kamez. Tirane Tirane TIRANE Rruga e "Kavajës", Bashkia Tiranë, tek ish Muzeu i Shkencave të Natyrës (Objekti GODINË POLIFUNKSIONALE 2,4,16 dhe 24 Kate "GARDEN BUILDING") Tirane Tirane TIRANE Rruga "28 Nëntori", Njësia Administrative Nr.7, Dy Godina Banimi, Shërbime dhe Hotel 7 dhe 8 Kate "Tirana Entry" Tirane Vore Muçaj Muçaj, Vore, Tirane, Zona Kadastrale 2726, Vol 8, Nr Pasurie 134/2-6 Tirane Tirane Ndertimi i Terminalit Verior te Transportit Publik, Tirane. 1001Tirane Dajt LINZE Rikonstruksion i objekteve te ish Repartit RENEa per akomodimin e Drejtorise se Forcave te Posacme Operacionale, me adrese Ish Reparti RENEa Tirane Tirane "Godine Multifunkcionale, Sherbimi, Hoteleri, Banim 58 kate mbitoke, me 7 kate nentoke", ZK.8150, Rruga e "Barrikadave", Bashkia Tirane, sipas Leje Ndertimi Nr.581/10 Prot., date 28.07.2023 Tirane Tirane TIRANE Tre godina banimi dhe institucione 6 dhe 8 kat dhe dy godina hotelerie dhe institucione 6 dhe 8 kate, me 1 kat parkim nëntokë, Rruga "29 Nentori ", Njesia Administrative nr.11.</p>
19. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	<p>Emri Tregtar: NOVA Construction 2012 E-Mail: nova_construction@yahoo.com Telefon: 0692083218</p>
20. Statusi:	Aktiv

Datë: 06/10/2023

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

VENDIM

Nr. 09 date 03/10/2023

ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE AKSIONEREVE/ORTAKEVE TE SHOQERISE

"NOVA CONSTRUCTION 2012" shpk

Sot, me date 03/10/2023 ne seline e Shoqerise "Nova Construction 2012" shpk, me numer identifikimi (NIPT) L22404012D, ne adresen Rr. "Kajo Karafili", Pallati Mc Inerte, Njesia Bashkiake Nr.10, Tirane, (me poshte i referuar si "Shoqeria"), u mbledh Asambleja e Aksionereve/Ortakeve te shoqerise "Nova Construction 2012" shpk, me numer identifikimi (NIPT) L22404012D, (me poshte i referuar si "Shoqeria") me perberjen e meposhtme:

1. Z. Ilir Shtufi, ortak 91% te kuotave te kapitalit, i cili ne kete mbledhje paraqitet personalisht;
2. Z. Kujtim Shtufi, ortak 9% te kuotave te kapitalit, i cili ne kete mbledhje paraqitet personalisht ;

Njoftimi per mbledhjen e asamblese dhe rendin e dites eshte derguar tek aksioneret/ortaket dhe sot ne mbledhje jane te pranishem aksioneret si me sipër percaktuar.

Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve/Ortakeve u mbledh per te diskutuar dhe vendosur sipas rendit te dites si me poshte vijon:

1. Miratimin per marrjen e kredise bankare ne vleren EUR 14,000,000 prane Raiffeisen Bank, ne cilesine e Bashkekredimarresit, ku shoqeria "Nova Solar Systems" shpk eshte ne cilesine e kredimarresit.
2. Miratimin per vendosjes si garanci duke barresuar 100% kuotave te shoqerise ne favor te Bankes me qellim garantimin e kredise se miratuar ne piken 1.
3. Autorizimin e Z. Ilir Shtufi, qe ne emer te shoqerise te negocioje, dhe te firmose te gjitha kontratat/marreveshjet respektive dhe te gjitha dokumentet e nevojshme te lidhura me kete financim prane Raiffeisen Bank sh.a.

Asambleja e Aksionereve/Ortakeve mori ne shqyrtim ceshtjet e ngritura dhe pasi diskutoi vendosi me unanimitet sa me poshte:


1. Miratimin per marrjen e kredise bankare ne vleren EUR 14,000,000 prane Raiffeisen Bank, ne cilesine e Bashkekredimarresit, ku shoqeria "Nova Solar Systems" shpk eshte ne cilesine e kredimarresit.
2. Miratimin per vendosjes si garanci duke barresuar 100% kuotave te shoqerise ne favor te Bankes me qellim garantimin e kredise se miratuar ne piken 1.
3. Autorizimin e Z. Z. Ilir Shtufi, qe ne emer te shoqerise te negocioje, dhe te firmose te gjitha kontratat/marreveshjet respektive dhe te gjitha dokumentet e nevojshme te lidhura me kete financim prane Raiffeisen Bank sh.a.

Ky vendim nenshkruhet rregullisht nga ortaket ne dy kopje origjinale, nje prej te cilave do te regjistrohet nepermjet portalit e-albania.


E firmosur sot me date 03/10/2023

"NOVA CONSTRUCTION 2012" shpk

Z. Ilir Shtufi



Z. Kujtim Shtufi

KUJTIMI SHTUFI


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER GJERGJ R. KONGOLI



V2023053630303844245

DATE 04/10/2023
NR REP 5070

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 04/10/2023 para meje Noter GJERGJ R. KONGOLI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA ADMINSITRATIVE NR. 10, RR. MIHAL DURI , u paraqit personalisht:

NËNSHKRUESIT:

Ilir Shtufi, atësia Xhemal, amësia Zonjë, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në TIRANË, me adresë Babë Rexha; Nd. 11; H. 1; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 13/10/1973, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033617734 dhe nr. personal H31013090C , .

Kujtim Shtufi, atësia Xhemal, amësia Zonje, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Bardhok Biba; Nd. 0; Njësia Administrative Nr. 9; Njesia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 01/02/1966, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034068541 dhe nr. personal G60201155M , .


Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, ne cilesine e ortakeve te Shoqerise Nova Construction 2012 shpk, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noterit, **Vendimin e asamblese nr., 09 date 03.10.2023** bashkëlidhur.

Unë Noteri pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



NOTER
GJERGJ R. KONGOLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ERNITA A. HAXHIU
ADRESA KAJO KARAFILL,
PALL. "MC INERIE"
TEL:

PROKURË E POSAÇME

Nr. repertori: 1220

Nr. koleksioni: 972

Tirane më 09/09/2023

ligjet referenca:

Legji nr. 7850, datë 29/07/1991 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

Legji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

Legjvuri 110, datë 20/11/2018 "Për Notarinë", i ndryshuar



A2023050660107064280



PROKURË E POSAÇME

Sot, me datë 09/09/2023, në Degan Vendore të Notoresë Tirane, para meje koteres, **ERNITA HAXHIU**, me seli në Tiranë në Rr. "Kajo Karafili", u paraqiten personalisht:

(I/E) PERFAQESUAR:

Z.Agim Zeqo, i biri i Nazmiut, lindur në Korçë dhe banorës në Tiranë, i datelindjes 26.08.1968, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar me Kartë identiteti Nr.**G80826036H**.

Edhe me dëshirë të lirë, vullnet të plotë dhe të pa vesuar, kërkoi nga unë Noteri perpiliain e kësaj prokure të posaçme në baza të nenit nr. 64, 70 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nëni 62, nëni 99 i ligjit 110/2018, si më poshtë vijon:

"Une i nënshkruari **Z.Agim Zeqo**, në cilësinë e ortakut të shoqërisë "NOVA SOLAR SYSTEM" shpk me 20% të kuotave, me NUIS M11824916H, si edhe në cilësinë personale si individ emeroj dhe caktoj nepërmjet kësaj Prokure, si përfaqësues të posaçem shtetasin **Z. Enea Mitrushi**, atësia flija, lindur në 23.08.1985 në Tiranë dhe banorës në Tiranë, identifikuar me letërnjoftim Nr.**I50823030K**, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar (me poshtë referuar si "Përfaqësuesi") të cili i qop tigrin për të vepruar në emër dhe për logari timen si më poshtë listuar:

1. Përfaqësuesi ka të drejtë të nënshkruajë dhe të marrë vendime në emër dhe logari timen personale, në cilësinë e ortakut të shoqërisë "NOVA SOLAR SYSTEM" shpk duke marrë pjesë në mbledhjet e asamblese së ortakëve të shoqërisë;

2. Përfaqësuesi ka të drejtë të në përfaqësojë dhe të nënshkruajë në emër dhe për logari timen personale kontratat të ndryshme kredie (Kontrata Kredie me Kufi, Kontrata Kredie, Kontrata për Lezhim të Instrumentave Financiare, Garancit Bankare, Letër Kredii që do të levizhen nga ana e Raiffeisen Bank sh.a në favor të Shoqërisë "NOVA SOLAR SYSTEM" shpk në cilësinë e Kredimorësit ku une jam ortak me 20% të kuotave të shoqërisë;

3. Përfaqësuesi ka të drejtë të në përfaqësojë personalisht si garancues dhe për të lenë kolateral në favor të Raiffeisen Bank Sh.a pasurite në emrin tim personal apo në emër të shoqërisë duke nënshkruar në emrin tim Kontrata Hipoteke, Marrveshje Siguruese dhe çdo document tjetër për të garantuar të gjitha detyrimet e kredise që shoqëria "NOVA SOLAR SYSTEM" shpk ka apo do të ketë në të ardhmen prane Raiffeisen Bank sh.a pa limitim në shume kredie. Si edhe të kryejë çdo veprim të nevojshem për të bërë të mundur regjistrimin regullisht të barrës hipotekore dhe barrave siguruese në favor të Raiffeisen Bank Sh.a mbi keto pasuri;

4. Përfaqësuesi ka të drejtë të firmosë në emrin tim personal Kontraten e Kredise/Dorezime të tilla ku une do të jem pale në cilësinë e dorezuesit për të garantuar të gjitha detyrimet e kredise që shoqëria "NOVA SOLAR SYSTEM" shpk ka apo do të ketë në të ardhmen prane Raiffeisen Bank sh.a pa limitim në shume kredie;

5. Për të plotësuar porositë e sipërmenendura përfaqësuesi ka të drejtë të nënshkruajë çdo dhe të gjitha dokumentet që do të paraqiten nga institucioni bankor Raiffeisen Bank sh.a dhe të kryejë çdo veprim pa asnjë lloj kufizimi duke caktuar heshitë çdo mangësi tigrash në këtë përfaqësim;

6. Përfaqësuesi ka të drejtë të ndërmerrë çdo dhe të gjitha veprimet që do të konsiderohen si të domosdoshme për realizimin e qëllimit të kësaj prokure të posaçme."

Kjo prokurë e posaçme është e vlefshme nga momenti i nënshkrimit të saj dhe në një kohë të përcaktuar, deri në mbarimin e saj, me të drejtën e revokimit të saj në çdo kohë.



I përfaqësuari deklaroi se: "Të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesi im i posaçëm brenda tagrave të përcaktuara në këtë prokurë, në mbështetje të të drejtave që më njeh legjislacioni në fuqi në shtetin Shqiptar, do të konsideroj të drejta e të mirëqena, sikur të ishin kryer prej vetë meje".

Prokura e Posaçme, u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të të përfaqësuarit, I cili e kuptoi përmbajtjen e saj dhe meqenëse shpreh vullnetin e tij të lirë e të plotë, u njoh dhe i kuptoi efektet e saj juridike, e nënshkroi atë rregullisht përpara meje Noteres.

Kjo Prokurë e Posaçme u hartua në gjuhën Shqipe prej meje Noteres në 3 (tre) kopje, me vlera të njëjta juridike, mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të të përfaqësuarit. Njëra kopje vendoset në arshivën noteriale, kopjet e tjera për të përfaqësuarin.

Unë Noterja, verifikova identitetin e të përfaqësuarit nëpërmjet dokumentit të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm në përputhje të plotë të neni 62, neni 99 i ligjit 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoi nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroi se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij akti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

(I/E) PERFAQESUAR:

Z.AGIM ZEKO

**NOTERE
ERNITA HAXHIU**